VENDIM
Nr.620, datë 11.6.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË, NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në universitetin "Aleksandër Xhuvani", Elbasan, të programeve të studimit të ciklit të dytë, sipas fakulteteve:

a) Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, programi i studimit "Mbrojtje mjedisi", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në mbrojtje mjedisi.

b) Në Fakultetin e Shkencave Humane, programi i studimit "Trashëgimi kulturore", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në trashëgimi kulturore.

2.Programet e studimeve të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është dy vite akademike.

3. Këto programe studimi do ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për universitetin "Aleksandër Xhuvani", Elbasan.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha